

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Ujesjelës Kanalizime” sha Roskovec
(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Ujesjelës Kanalizime sha Roskovec

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

(të Ushtrimit të mbyllur më datë 31.12.2019)

29 Mars 2020

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec
(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec është Shoqëri aksionere, themeluar me dt. 26.09.2016 me aksionere te vetme Bashkine Roskovec, regjistruar ne Drejtorine Rajonale Tatimore Fier me NIPT L63327402A.

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet sipas dispozitave te Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare” i ndryshuar, nga statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

Selia e shoqërisë është në Rruga nacionale Fier-Berat, rruga Syri Balla, Roskovec.

Objekti i veprimtarisë se Shoqërisë “Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec eshte: “Furnizimi me uje pishem dhe largimi i ujrave te ndotura”.

Shoqëria “Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec **administrohet** nga administratori i shoqërisë z. Isa Hoxha, i cili ka kompetenca për drejtimin e saj mbi bazën e statutit.

Pasqyrat financiare jane hartuar ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara.

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte sipas natyres dhe eshte hartuar sipas te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Pasqyra e fluksit te parase eshte paraqitur me metoden indirekte.

Kerkesat per arketim dhe detyrimet jane paraqitur me vleren neto te realizueshme.

Gjendjet financiare janë shprehur në lekë. Veprimet janë regjistruar në mënyrë kronologjike në librat e kontabilitetit. Çdo veprim është mbështetur në dokumenta justifikues dhe dokumenta kontabël të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në kontabilitet jane regjistruar te gjitha transaksionet financiare që i takojnë periudhes ushtrimore 2019, dhe që ndikojnë në rezultatin e këtij ushtrimi. Veprimet janë ngurtësuar me 31 dhjetor 2019.

Aktivitet afatgjata materiale paraqiten në bilanc me koston historike.

Shpenzimet janë kontabilizuar në bazë të dokumentave justifikuese.

Të ardhurat janë kontabilizuar në bazë të faturave tatimore.



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec
(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Postet e bilancit paraqiten:

Aktive monetare per 697 322 leke, paraqesin mjete monetare ne banke. Shoqeria operon me Raiffeisen Bank dhe Banken Credins, te gjitha veprimet jane rregjistruar ne ditaret perkates, gjendja e tyre perputhet me postat e bankes.

Te drejta te arketueshme në vlerën 32 703 275 lekë detajohen si më poshtë:

Nga aktiviteti i shfrytezimit ne shumen 32 611 420 leke paraqet llogarine Kliente per vleren e faturave te paarketuara, kjo llogari eshte e analizuar sipas klienteve dhe rakordon me llogarine sintetike.

91 855 leke jane vlera nga shitja e sahateve dhe te pa arketuara nga ana e punonjesve te ujesjellesit.

Llogarite inventariale paraqesin **“Lende te para e materiale te konsumueshme”** per 1 329 585 leke e inventar te imet ne shumen 52.000 leke.

Aktive afatgjata materiale

Shoqeria ka nje vlere neto aktivesh afatgjata materiale per 591 640 364 leke, aam jane shtuar gjate vitit 2019 ne shumen 94 610 341 leke, ne zerin Te tjera Instalime teknike dhe pajisje ne shumen 8 991 472 leke, 270 000 leke nga blerjet tona dhe 8 721 472 trasferuar nga Bashkia Roskovec , ne zerin toka dhe ndertesa ne shumen 20 659 011 leke dhe ne zerin Impiante dhe makineri ne shumen 64 959 858 leke. Aktivet afatgjata materiale jane pakesuar per amortizimin e llogaritur ne shumen 30 001 850 leke dhe eshte kontabilizuar per te njejten shifer ne shpenzime, shuma e llogaritur nuk kalon kufijte e percaktuar nga ligji.

Kapital i nenshkuar i pakerkuar ne shumen 2 600 000 leke paraqet kapitalin e nenshkuar te paderdhur nga aksioneri.

DETYRIMET DHE KAPITALI

Kapitalet e veta paraqiten me vlerë -86 147 056 lekë.

Kapitali i nënshkuar i shoqërisë është 3 500 000 lekë, ai perputhet me ekstraktin historik te shoqerise te nxjerre nga QKB.

Humbje te mbartur ne shumen 50 532 671 leke.

Humbje e ushtrimit sipas bilancit kontabël paraqitet per 39 114 385 leke.



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec
(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit per 28 567 533 leke paraqesin llogarine furnitore per vlerën e faturave të palikujduara, kjo llogari është e analizuar sipas furnitoreve dhe rakordon me llogarinë sintetike të tyre.

Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore paraqitet detyrimi i shoqerise per pagat e punonjesve ne shumen 3 686 803 leke dhe sigurimet shoqerore ne shumen 527 046 leke.

Detyrimet tatimore paraqesin:

- **Tvsh** 2 019 213 leke.
- **Tap** 15 826 leke

Te tjera detyrime per 15 300 leke paraqet detyrim te shoqerise ndaj te treteve per objekte të marra me qera.

Verifikimi i llogarise Fitime Humbje

Shpenzimet dhe të ardhurat janë grupuar si më poshtë:

	Viti 2019	Viti 2018
Te ardhura		
Nga shitja e mallrave	24 860 295	23 667 237
Te ardhura te tjera te shfrytezimit	1 194 925	550 462
Totali (Afarizmi)	26 055 220	24 217 699
Materiale te konsumuara	1 529 865	1.101.357
Kosto e punes	26 827 860	24.073.458
Pagat e personelit	22 988 740	20.628.499
Shpenzime te tjera per personelin		
Shpenzimet per sigurime	3 839 120	3.444.959
Amortizimi dhe zhvleresimet	30 001 850	28.368.343
Shpenzime te tjera	12 416 595	12.716.716
Totali I shpenzimeve	70 776 170	66.259.874
Te ardhurat nga subvencionet	3 881 861	10.747.617
Ter ardhura nga kamata	629 146	359.018
Te ardhura te tjera	1 095 558	
Humbje ushtrimit	(39 114 385)	(30.935.540)

Shpenzimet jane 70 776 170 leke, ndersa te ardhurat 31 661 785 lekë. Rezultati neto që shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj gjate ketij viti ushtrimor është humbje ne shumen 39 114 385 leke.

Te ardhurat perfagesojne te ardhura nga shitja e ujit dhe largimi i ujrave te ndotura per 24 860 295 leke, te ardhura nga kontratat e reja ne shumen 279



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

500 leke dhe te ardhura nga kamatat ne shumen 629 146 leke. Te ardhura te tjera jane realizuar nga shitja e sahateve ne vleren 904 210 leke, komisione si agent tatimor per B.Roskovec ne vleren 11 215 leke dhe te ardhura nga B.Roskovec per blerje materiale ne vleren 1 095 558 leke. Gjithashtu ne te ardhura jane perfshire edhe subvencionet e dhena nga Qeveria qendrore te cilat kane kaluar per likujdim detyrime ndaj DPT dhe likujdim paga shtator 2019 ne shumen 2 736 462 leke.

Subvencione nga Bashkia Roskovec per likujdim detyrime tatimore per pergjegjesine Sigurime shoqerore dhe shendetesore ne shumen 1 134 861 leke. Shitjet jane rregjistruar korrekt ne librat e shitjeve dhe te ardhurat rakordojne me situaten tatimore.

Shpenzimet per 70 776 170 lekë, jane te justifikuara me dokumenta te rregullta fiskale. Me konkretisht shpenzimet sipas zërave paraqiten:

Shpenzime per mallra ne shumen 1 529 865 lekë, ato janë përdorur për veprimtarinë kryesore të shoqërisë, këto shpenzime janë të justifikuara me dokumenta.

Personeli, në këtë llogari janë pasqyruar shpenzimet për paga 22 988 740 lekë, dhe sigurime shoqërore 3 839 120 leke, shpenzimet për paga e sigurime janë vendosur korrekt në këtë llogari.

Shpenzime amortizimi ne vleren 30 001 850 leke nuk i kalon kufijte e fiskut.

Shpenzime te tjera per 12 416 595 leke paraqesin:

- shpenzime per qera 216 000 leke,
- shpenzime energji elektrike per 9 726 818 leke,
- komisione banke 7 900 leke,
- Keshilli i Administrimit dhe ekspertet Kontabel 1 096 320 leke,
- Shpenzime sistemi i faturave 84 000 leke
- Shpenzime mirembajtje dhe riparime 83 000 leke
- shpenzime te tjera dhe gjoba 1 202 557 leke,

Rezultati ushtrimor neto që shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj është humbje ne shumen 39 114 385 leke leke.



DREJTOR TREGTAR
Matilda GISHTI